



Bazuar në nenin 44 të Ligjit për Policinë e Kosovës, Nr. 04/L-076, Udhëzimin Administrativ 02/2023 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës neni 26, si dhe aprovimin e Drejtorit të Përgjithshëm datë: 20/02/2026 me nr ref: DPA-10/018/2026, Policia e Kosovës shpall:

K O N K U R S

Datë:06.03.2026

Referenca: 10/1-01/SRS/0054/2026

Për plotësimin e vendeve të punës

1. **Titulli i vendit të punës:** Zyrtar i lartë në flotën operative (**Auto-Mekanikë**)- dhjetë (10) vende të lira pune

Vendi i punës: Ekipi i Specialistëve të Auto-Mekanikëve / Njësia Specialistëve të Auto-Servisit / Sektori i Flotës Operative / Drejtoria e Logjistikës.

Klasa: Profesional 1

Koeficienti: 6.7

Bazuar ne Ligjin nr. 10/L-001 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës se Kosovës nenit 31 paragrafi 1 për vitin 2026 mbetet në fuqi për vitin fiskal 2026 rritja e koeficientit të pagës për një (1) njësi të bërë me Ligjin Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2025 për të gjitha klasat e pozitive sipas Shtojcave 1 - 15 të Ligjit Nr. 08/L-196 të Pagave në Sektorin Publik.

Kohëzgjatja e emërimit: Me afat të caktuar, dy (2) vite

Orari i punës: i plotë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Kryen servisimin dhe rregullimin e sistemeve komplekse dhe të avancuara të Automjeteve të rëndësisë së veçantë (autoblindave, topa të ujit etj);
- Kryen servisimin e rregullt të automjeteve të PK-së konform planifikimit dhe kërkesave për të siguruar që të gjitha automjetet e PK-së të jenë funksionale;
- Kryen rregullimin e motorit të automjetit (koka e motorit, blloku i motorit, pistoni i motorit, boshti brrylor, boshti bregor, rrypi dhëmbëzor, hidraulikët etj.);
- Kryen rregullimin e transmisionit të automjetit (rregullimi i ndërruesit, ndërrimi i set Ila mellës, rregullimi i bushtit kardanik, rregullimi i deferencialit, ndërrimi i gjysmë boshteve etj.);
- Kryen rregullimin/gjeometrinë e sistemit të drejtimit të automjetit (koka e timonit, spona, mollëzat etj.);
- Kryen rregullimin/testimin e sistemit mbështetës të automjetit(amortizatorët, spiralet, gominat, pirunat etj.);

- Kryen rregullimin/testimin e sistemit frenimit të automjetit (gurtne, diska, cilindra, gypa etj.);
- Identifikon nevojat për pjesë rezervë, njofton mbikëqyrësin, analizon dhe vlerëson faktorët me të shpeshtë të prishjeve të automjeteve;
- Nëse vëren se prishja e automjetit është shkaktuar si pasoj e papërgjegjësisë së vozitësit informon mbikëqyrësin për procedura të mëtutjeshme;
- Kujdeset që çdo riparim në automjete të jetë sipas radhës dhe nevojave urgjente të paraqitura si dhe është përgjegjës për koordinimin e punës me njësit tjera të servisit që çdo riparim të jetë i kompletuar sipas nevojave të paraqitura për riparim të automjetit;
- Asiston njësit policore (autokrimet, antidrogën, forenzikën etj) në hapjen, kontrollimin dhe ekzaminimin e automjeteve;
- Është përgjegjësi dhe detyre që gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare të angazhohet në mbledhjen e informatave të inteligjencës nga të gjitha burimet në dispozicion;
- Kryen edhe punë tjera që ia përcakton mbikëqyrësi i drejtpërdrejt në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore, të cilat me arsye mund të kërkojnë kohë pas kohe dhe të cilat nuk cenojnë dinjitetin e punonjësit.

Shkollimi dhe shkathtësitë për pozitën e kërkuar:

- Shkollim i mesëm i paspecifikuar;
- Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale;
- Aftësi profesionale dhe motivuese;
- Posedim të standardeve të larta etike;
- Të ketë aftësi për të punuar në grup, në ambient multietnik;
- Të ketë shkathtësi të dëshmuara të komunikimit me shkrim dhe me gojë;
- Nivel të lartë të ndershmërisë dhe konfidencialitetit;

Kërkesat e përgjithshme për pranim janë:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të kenë nivelin e arsimit dhe përvojën e punës të kërkuar për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës;
- Të ketë integritet personal dhe vlera të larta etike;
- Të kalojnë me sukses procedurat e pranimit.

Forma e aplikimit:

Aplikimi mund të bëhet në dy mënyra:

1. Aplikimi online ose
2. Aplikimi në formë fizike.

1. **Aplikimi online** bëhet përmes ueb faqes zyrtare të PK-së:
www.kosovopoliice.com/Shpallje/Mundësi_punësimi.

Në aplikimin online duhet bashkangjitur dokumentet e kërkuara si:

- a) Kopja e diplomës për arsimin e kërkuar, ndërsa për kandidatët që kanë përfunduar shkollimin jashtë vendit kopjen e diplomës e nostrifikuar;
 - b) Dëshmi për kualifikime tjera, dëshmi për përvojën e punës;
 - c) Certifikata e Gjendjes Penale (jo me i vjetër se 6 muaj);
 - d) Një fotografi të formatit (5 x 5).
2. **Aplikimi në formë fizike** - Formularët për aplikim janë në dispozicion në ueb-faqen e Policisë së Kosovës www.kosovopolic.com ku gjendet shpallja e konkursit.

Në aplikimin në formë fizike duhet bashkangjitur dokumentet e kërkuara si:

- a) Formulari për aplikim se bashku me Deklarata (lidhur me pajtueshmërinë e hetimeve të së kaluarës), mund ta shkarkoni në ueb-faqen e Policisë së Kosovës www.kosovopolic.com;
- b) Kopja e diplomës për arsimin e kërkuar, ndërsa për kandidatët që kanë përfunduar shkollimin jashtë vendit kopjen e diplomës e nostrifikuar;
- c) Dëshmi për kualifikime tjera, dëshmi për përvojën e punës;
- d) Çertifikata /ekstraktin e lindjes (jo me i vjetër se 6 muaj);
- e) Çertifikata e gjendjes penale (jo me i vjetër se 6 muaj);
- f) Kopja e letërnjoftimit ose pasaportës valide;
- g) Një fotografi të formatit (5 x 5).

Formularët duhet t'i dorëzohen në Sektorin për Rekrutim dhe Seleksionim, Ndërtesa e re e Administratës, DPP, Prishtinë, personalisht ose dërgohen me postë në këtë adresë: **Policia e Kosovës, rr. "Luan Haradinaj", 10000 Prishtinë, Sektori për Rekrutim dhe Seleksionim, kati i III, zyra 54**, çdo ditë pune nga ora 09:00-15:00 deri në afatin e fundit për konkurrim. Dokumentet e pranuar nuk do të kthehen!

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen.

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin:

Bazuar në aktet ligjore të lartpërmendura të gjitha aplikacionet dhe dokumentacioni i pranuar do të shqyrtohet me kujdes dhe gjatë shqyrtimit nëse konstatohet se kandidati nuk i plotëson kriteret e përcaktuara për aplikim dhe punësim, apo nëse aplikacioni përmban të dhëna të rrejshme kandidati menjëherë do të diskualifikohet. Kandidatët e suksesshëm do të ftohen të marrin pjesë në intervistë. Këto pozita i nënshtrohen procesit të verifikimit dhe mund të plotësohet vetëm pas përfundimit të suksesshëm të procesit të verifikimit.

Kandidatët të cilët kanë ndonjë vërejtje në procesin e rekrutimit dhe seleksionimit për çdo fazë të testimit, kanë të drejtë të ankohen.

Informimi i kandidatëve lidhur me çdo faze të testimit do të behet përmes publikimit të listave në ueb - faqen e Policisë së Kosovës, në adresën: www.kosovopolic.com, te rubrika mundësi e punësimit.

Data e fillimit dhe e mbylljes së konkursit:

Konkursi do të jetë i hapur nga data **06.03.2026** deri me **23.03.2026**.

Numrat kontaktues: Për informata plotësuese mund të thirrni në numrin e telefonit kontaktues nr.: 038- 5080 lokali: 1002 /038-504504 lokali:1751dhe 038 245 184 si dhe në adresën elektronike rekrutimi@kosovopolic.com.

"Policia e Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë, si dhe personat me aftësi të kufizuara".